

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"EcoCare Laundry" shpk**

Sot, më 02.06.2025, ne, themeluesit,

- a) **Silva Perolli**, atësia Sadik, shtetas shqiptare, identifikuar me numër personal identifikimi I25531068U, i datëlindjes 31.05.1982, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- b) **Klaudia Zyberi**, atësia Luan, shtetas shqiptare, identifikuar me numër personal identifikimi I36116038M, i datëlindjes 16.11.1983, lindur në Berat dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është **"EcoCare Laundry" shpk**.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
 - a) Lavanderi profesionale dhe shërbime të ngjashme. Larje, tharje, hekurje, paketim, ngjyrosje, lyerje dhe konfeksionime të ndryshme për cdo lloj tekstili. Pastrim kimit, larje kimike, grafiature, ngjyrosje dhe procese të ndryshme për tekstile të ndryshme.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në Tiranë në adresën: Rruga "Gani Domi", Pall.1, Ap.1, Shk.1.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.



Neni 5
Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 3.000.000 (tre milion) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a) Ortaku themelues Silva Perolli, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b) Ortaku themelues Klaudia Zyberi, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6
Administratori

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet Silva Perolli, atësia Sadik, shtetas shqiptarë, identifikuar me numër personal identifikimi I25531068U, i datëlindjes 31.05.1982, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me afat emërimi 5 vjeçar.


Neni 7
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 8
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

ORTAKËT
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"EcoCare Laundry" shpk



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)